



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2019:078043

Datë: 19.04.2019

Numri i dokumentit: 00285502

*P.nr.203/19*

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikanen Albina Dubova, në lëndën penale kundër të akuzuarit **Y. H.**, nga Gjilani, për shkak të veprës penale, **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr.268/2019, të datës 28.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 17.04.2019, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndersa e përpiloi me datë 18.04.2019 këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **Y. H.**, nga babai ..... dhe nëna ....., e gjinisë ....., i lindur më datë 17.04.1998 në Gjilan, ku edhe jeton rr. “.....” nr.5, i pa martuar, i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse, më dt.12.02.2019, rreth orës 00:05 min , në Gjilan në rrugën “.....” i pandehuri **Y. H.** pa leje dhe autorizim ka poseduar substancë narkotike, në atë mënyrë që i njëjti në momentin që është ndalur dhe kontrolluar nga ana e zyrtarëve policor, është konstatuar se posedon substancë narkotike të llojit Marihuanë në sasi prej 2.1 gramë, ashtu që i pandehuri me veprimet e tije pa leje dhe pa autorizim ka poseduar substancë narkotike.

-me çka ka kryer veprë penale, **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

**E G J Y K O N**  
**ME DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarin **Y. H.**, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (nje) viti**, nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë,

Obligohet i akuzuari që të paguaj **paushallin gjyqësor** në shumë prej **10 (dhjetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike **udhëzohen në kontest civil.**

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjiilan,- Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr. 268/2019, të datës 28.02.2019, kundër të akuzuarit Y. H., për shkak të veprës penale, **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së** dhe ka kërkuar që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan Departamenti i Përgjithshëm, Huma Jetishi, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues, pasi në seancën e sotme gjyqësore, i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të cilin pranim, gjykata e ka njoftuar për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajsisë, e mbi bazën e këtij pranimi dhe provave të tjera që gjenden në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit, i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërin shoqërore të kësaj vepre penale.

I akuzuari Y. H. deklaroi se është penduar, i vjen keq për këtë vepër penale, premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris këtë vepër e as vepra të tjera penale, e din që ka gabuar, premtoi se do të jetë më i kujdesshëm në komunikacion, andaj kërkoi nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari Y. H. e ka kryer veprën penale, **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, pendimi i tijë, si dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr.203/2019, më datë 18.04.2019**

**Praktikantja,**  
Albina Dubova , d.v

**Gjykatësja e vetme gjyqësore,**  
Luljete Shabani, d.v

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj Gjykate.